



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
SHKOLLA MEKANIKE BUJQËSORE "HASAN D. GINA" LUSHNJË

Nr. 361 prot.

Lushnjë më 17.08.2021

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr.14, datë 27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësive të zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit",

Ofruesi publik i AFP-së shkolla mekanike bujqësore "Hasan D. Gina" Lushnje, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin: **ndrejtor te kultures profesionale**.

Pozicioni

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plote për të vepruar.
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të organizimit dhe planifikimit strategjik, aftësi analitike për zgjidhjen e problemeve;
- g) të demonstrojë aftësi drejtuese, të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) Te kete diplome nga nje institucion i arsimit te larte te nivelit "Master shkencor" (ose te barasvlershme per nje nga profilet qe lidhet me zhvillimin e kultures profesionale te ofruesit te AFP-se.
- b) Te kete te paktën kategorine "Mesues i kualifikuar".
- c) Te kete punuar te paktën 5 vjet ne nje ofrues publik te AFP-se;
- d) Te kete njohuri te certifikuara ne perdorimin e teknologjise se informacionit.
- e) Te kete pervojë pune te paktën 3vjet ne fushen qe lidhet me kualifikimet profesionale te njerit prej drejtimeve mesimore te AFP-se.

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) - letërmotivimin për pozicionin;
- b) - jetëshkrimin (CV-në);
- c) - kartën e identitetit;
- d) - diplomën;
- e) - librezën e punës;
- f) - çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) - certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) - vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i) - vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j) - vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;
Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës 07.09.2021

DREJTORI I SHKOLLES

Ardjan PRIFTI

